SGS Automotive Albania sh.p.k

Pasqyrat Financiare
me shenimet shpjeguese
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

SGS
TIRANA

PËRMBAJTJA

	PAGE
PASQYRA FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSEVE E TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 22

SGS Automotive Albania sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 20112
Aktivet			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata jomateriale	4	598,062,671	626,019,639
Totali i aktiveve afatgjata		**598,062,671**	**626,019,639**
Aktivet afatshkurtra			
Inventari	5	1,952,682	5,224,048
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	6	17,996,979	16,484,008
Parapagime tatim fitimi		-	4,496,651
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	7	293,519,210	133,285,763
Totali i aktiveve afatshkurtra		**313,468,871**	**159,490,470**
TOTALI I AKTIVEVE		**911,531,542**	**785,510,109**
KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali aksionar	8	190,000,100	190,000,100
Humbja e akumuluar		(27,143,821)	
Fitimi (Humbja e Periudhes)		86,932,973	(27,143,821)
Totali kapitalit		**249,789,251**	**162,856,279**
Detyrimet			
Detyrime afatgjata			
Vlera e riinvestimit	11	160,372,800	130,668,400
Totali i detyrimeve afatgjata		**160,372,800**	**130,668,400**
Detyrime afatshkurtra			
Huatë afatshkurtra	9	436,049,433	437,514,169
Llogaritë afatshkurtra	10	61,508,941	54,471,261
Tatim fitimi i pagueshëm		3,811,114	-
Totali detyrimeve		**501,369,491**	**491,985,430**
Totali kapitalit dhe detyrimeve		**911,531,542**	**785,510,109**

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë dhe firmosur më 20 mars 2014 nga dhe firmosur nga:

Z. Alexandros Michail — *Mirketa Puriqi*

Administrator. — *Drejtor Finance*

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SGS Automotive Albania sh.p.k.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
I. Të ardhura operative			
Të ardhura	12	634,514,031	539,886,302
Totali të arshura operative		**634,514,031**	**539,886,302**
Shpenzimet			
Materiale dhe të përdorurar për konsum	13	(14,389,760)	(11,691,834)
Shpenzime personeli	14	(163,664,176)	(158,479,202)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4	(83,564,155)	(74,171,997)
Shpenzime të tjera operative	15	(234,861,546)	(215,198,267)
Totali shpenzimeve		**(496,479,636)**	**(459,541,300)**
Fitim nga aktiviteti operacional		**138,034,395**	**80,345,002**
Shpenzime dhe të ardhura financiare			
E ardhuara financiare		461,366	1,760,265
Shpenzime financiare		(36,762,347)	(43,339,135)
Shpenzimeve financiare, neto	16	**(36,300,980)**	**(41,578,871)**
Fitimi para tatimit		**101,733,414**	**38,766,131**
Tatimi mbi fitimin	17	(14,800,442)	(6,492,672)
Fitimi neto i vitit		**86,932,972**	**32,273,459**

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SGS Automotive Albania sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali aksionar	Fitimi (humbja) i akumuluar (rishikuar)	Totali
Më 31 dhjetor 2011	**190,000,100**	**(59,417,280)**	**130,582,820**
Fitimi i vitit	-	32,273,459	**32,273,459**
Të ardhura të tjera	-	-	-
Më 31 dhjetor 2012	**190,000,100**	**(27,143,820)**	**162,856,280**
Fitimi i vitit	-	86,932,972	**86,932,972**
Të ardhura të tjera	-	-	-
Më 31 dhjetor 2013	**190,000,100**	**59,789,152**	**249,789,252**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SGS Automotive Albania sh.p.k
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Fluksi monetar i gjeneruar nga aktivitetet operative:		
Fitimi pas tatimit	86,932,972	32,287,614
Rregullime për:		
Amortizimin dhe zhvlerësimin	83,564,155	74,171,997
Humbje nga kursi i këmbimit	13,500	971,113
Të ardhura interesi	461,366	-
Shpenzime interesi	36,556,300	42,117,509
Shpenzime tatim fitimi	14,800,442	6,491,672
Humbjet nga aktivitetipara ndryshimeve në kapitalin punues	**221,379,003**	**156,040,905**
Rënie / (rritje) në inventar	3,271,367	(1,536,911)
Rënie / (rritje) në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(1,512,970)	(526,822)
(Rënie) /rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	36,742,079	5,467,755
Interesi paguar	(38,021,036)	(35,377,994)
Tatimi fitimi paguar	(6,492,676)	(9,994,295)
Fluksi monetar neto gjeneruar nga aktivitetet operative	**(6,013,235**	**114,072,638**
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:		
Blerja e aktiveve afatgjata material	(55,593,687)	(24,137,545)
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	-	-
Interesa të arkëtuara	461,366	-
Flukset monetare neto përdorur nga aktivitetet investuese	**(55,132,321)**	**(24,137,545)**
Flukset monetare gjeneruar nga aktivitetet e financimit		
Kapital i paguar	-	-
Shlyerje e huasë, neto	-	(73,569,262)
Fluksi monetar i gjeneruar nga aktivitete financuese	**-**	**(73,569,262)**
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	**160,233,447**	**16,365,831**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	133,285,763	116,919,932
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	**293,519,210**	**133,285,763**

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6-22 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

SGS Automotive Albania sh.p.k (Shoqëria) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e rregjistruar më 10 shtator 2009 në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Tiranë, Rr. Irfan Tomini, Ndërtesa G & P, Kati i parë, Tiranë.

Shoqëria mëmë është SGS Societe General De Surveillance s.a., Gjenevë, Zvicër, e cila më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 zotëron 100% të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë.
Aktivitet kryesore të Shoqërisë lidhen me inspektimin teknik të mjeteve automoblistike, për një periudhe 10 vjeçare siç është rënë dakord në kontratën e konçensionit ndërmjet SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë, e cila ka rolin e autoritetit kontraktues . Shoqëria operon në tregun vendas dhe ka hapur 15 pika në të gjithë vëndin.

Më 31 dhjetor 2013 punonjësit e Shoqërisë janë 120 (31 dhjetor 2012: 112).

Marrëveshja e Konçesionit

Përshkrimi i marrëveshjes
Sipas Nenit 100 te Kushtetutes dhe Nenit 21 te Ligjit Shqipëtar nr. 9663 " Ligji i Konçesionit" (i ndryshuar) të datës 18 dhjetor 2006, vendimit të këshillit të ministrave nr. 27, i titulluar " Mbi aprovimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së konçesionit", i datës 19 janar 2007, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 643, te titulluar " Mbi zgjedhjen e Autoritetit Kontraktual për dhënien e konçesionit të kontrollit të kërkuar teknik për mjetet dhe kamionët e tyre në Republikën e Shqipërisë, për (i)projektimin, financimin, rehabilitimin, testimin, përdorimin dhe mbajtjen qendarve të kontrollit teknik ekzistuese dhe makineritë dhe mjetet ekzistuese përgjatë periudhës së konçesionit; (ii) projektimin, financimin, ndërtimin, testimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit Qeverisë së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë dhe SGS General De Surveillançe s.a që ka hyrë në marrëveshjen e konçesionit më datë 3 shtator 2009 ("Marrëveshja e Konçesionit")".

Periudha e konçesionit
Konçesioni është dhënë për një periudhë prej 10 vitesh që fillon nga data efektive (3 shtator 2009).

Objekti i konçesionit:
Dhënësi i grantit i jep Operatorit të drejtën të:
1. Të projektojë, financojë, rehabilitojë, testojë, mbajë dhe të përdorë QKT egzistuese dhe makineritë dhe mjetet për periudhën e konçesionit.
2. Të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, mbajë dhe në fund të periudhës së konçesionit të transferojë QKT dhe mjetet dhe makinerite e saj sutoritetit kontraktues.
3. Ti ofrojë klientëve shërbimin e kontrollit të detyruar teknik per mjetet (makinat). Të ofrojë shërbim profesional sipas kësaj marrëveshjeje, manualit të kontrollit dhe ligjit në fuqi.

Dorëzimi i konçesionarit QKT
1. Në fund të periudhës së marrëveshjës Operatori duhet ti kthejë QKT egzistuese Dhuratëdhënësit.
2. Në fund të periudhës së marrëveshjës Operatori duhet ti kthejë dhënësit të grantit QKT-në e sapondërtuar dhe makinerite dhe pajisjet e saj.
3. Operatori duhet ti transfrojë gjithashtu pajisjet elektronike dhe kompjuterike, ndërtimin në progres, marrëveshje liçensimi mbi programe kompjuterike, të drejta kontraktuale, rregjistrimet në llogari etj.

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

1.1 Marrëveshja e Konçesionit (vazhdim)

Te drejtat e Konçesionarit

- Të ushtrojë të gjitha te drejtat në lidhje me përdorimin eskluziv të Sheshit dhe të Paisjeve Ekzistuese, dhe të Paisjeve Elektromekanike dhe Kompjuterike (nga data e instalimit)
-Të punësojë apo angazhojë punonjës me qëllim zbatimin e Konçesionit si dhe të hartojë politikën e vet të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Kontratë
- Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate.
- Të kërkojë zgjatjen e Periudhës së konçesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontratë.

Detyrime të Përgjithshme të Konçesionarit

- të zbatojë projektin e konçesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate dhe anekset e saj.
- brenda 5 muajve, konçesionari duhet të ketë përfunduar rehabilitimin e QKT-ve ekzistuese si dhe në përputhje me ligjin.
- brenda 6 (gjashtë) muajve nga paisja me leje ndërtimi, konçesionari duhet të ketë përfunduar së ndërtuari QKT-në e Re.
- të ofrojë dhe kryej shërbimin e kontrrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në përputhje me ligjet, manualin e kontrrollit të mjeteve, praktikat e industrisë së mirë dhe ofertën e konçesionarit dhe të mbajë të pacënuar ofrimin e këtij shërbimi.
- nga data efektive të zbatojë si orar minimal pune në QKT ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL, orarin e hënë – e premte 09:00-17:00 dhe e shtunë 08:00-13:00. Konçesionari gjatë këtij orari detyrohet të mbajë funksionale QKT Ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL . Ky orar mund të jetë objekt rishikimi me marrveshje me shkrim mes palëve mbi kërkesën e paraqitur nga pala e interesuar.
- të lejojë autoritetin kontraktues të inspektojë secilën nga QKT ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në çdo kohë të arsyeshme me ose pa njoftim paraprak.
të kryejë kontrrolle teknoke të gjitha mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre të paraqitura në testim në perputhje me Manualin e Kontrrollit të Mjeteve.
- të mirmbajë QKT ekzistuese, QKT të Re dhe QKTL, paisjet ekzistuese dhe paisjet elektromekanike dhe kompjuterike deri në momentin e kthimit mbrapsht tek autoriteti kontraktues sipas kushteve të kësaj Kontrate në përputhje me praktikat e industrisë së mirë.
- të përballojë vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet e çdo natyre lidhur me largimin dhe transportimin nga sheshi të paisjeve ekzistuese në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontrakues në përfundim të fazës së ndërtimit.
- të ruajë të gjitha vërtetimet e papërdoruura apo të palëshuara për rezultatet e kontrrolleve të kryera në QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në një vend të sigurt nën kontrrollin e konçesionarit dhe në kushte të përshtatshmepër t'i ruajtur ato nga dëmtime të çdo lloji si psh. mekanike, atmosferike, etj.
- t'i paraqesë autoritetit kontraktues në kohë të përshtatshme sapo t'i kërkohet prej tij informacione apo çdo dokument të kërkuar që ka të bëjë me funksionimin e QKT Ekzistuese, QKT e Re dhe QKTLsi dhe të shërbimit.
- të shoqërojë çdo pagesë të tarifës konçesionare me një raport dhe dokumenta të nevojshëm plotësues mbi xhiron e realizuar nga tarifat e kontrrollit dhe tarifat e rikontrrollit për periudhën për të cilën pagesa e tarifës konçesionare kryhet.
- të krijojë një bazë të dhënash elektronike të re dhe bashkëkohore dh eta përditësojë atë periodikisht. specifikimet teknike për realizimin e këtij proçesi do të përcaktohen nga ana e stafeve teknike përkatëse të të dy palëve.

SGS AUTOMOTIVE ALBANIA SH.P.K TIRANË

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM (VAZHDIM)

1.1 Marrëveshja e Konçesionit (vazhdim)

- në fund të periudhës konçesionare të transferojë (pa shpërblim apo pretendim tjetër monetary apo të çdo lloji) tek autoriteti kontraktues pronësinë mbi QKT e Re, QKTL, linjat e kontrrollit dhe paisjet elektromekanike dhe kompjuterike në gjendje funksionale, përjashtuar amortizimin normal, ashtu siç do të jenë pas kryerjes së riinvestimit.
- të mos kryejë shërbimin ndaj mjeteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet fiskale që lidhen me përdorimin e mjeteve të tilla si: Taksa vjetore e qarkullimit mugor, Taksa vjetore e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe gjobat për mosparaqitjen brenda afateve për kryerjen e shërbimit në qendrat e kontrrollit teknik.
- brenda muajit të parë të vitit kalendarik 7 të periudhës konçesionare, konçesionari duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor, kalendarin e punimeve të riinvestimit, ku të jenë përcaktuar afatet e riinvestimit dhe vlerat përkatëse sipas zërave.

Tarifat e konçesionit
Operatori duhet ti paguajë Dhuratëdhënësit një tarifë prej 5% të fitimit vjetor (para taksës së të ardhurave).

Tarifa e konçesionit do të llogaritet dhe paguhet çdo muaj duke filluar nga data efektive - 3 shtator 2009.

Investimet e operatorit
Operatori duhet të bëjë një investim me qëllim që të bëjë të mundur ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik. Investimi duhet të jetë 561,003,000 Lek nga të cilat 267,402,000 Lek duhen për pajisjet Elektro-mekanike dhe kompjuterat.

Riinvestimet e Operatorit
Operatori ka detyrimin ta mirëmbajë pronën nën konçesion. Operatori do të investojë në tre vitet e fundit te marrëveshjës një shumë prej 172.000.000 Lek e cila përbën 30.7% të investimit të operatorit.

Nëse operatori nuk ka bërë riinvestimin e plotë përpara se marrëveshja e konçesionit të mbarojë, ai duhet ti paguajë diferencen grantit të konçesionit.

2. BAZAT E PERGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmerisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi Ndërkombëtarë i Standardeve Kontabël (BNSK) dhe interpretimeve të lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtarë i Interpretimeve të Raportimeve Financiare (KNIRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF për secilin prej aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më poshtë në politikat kontabël.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar ne Lek Shqiptar "Lek".

2 BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultate aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimial në pasqyrat financiare kontabël duke marrë parasysh natyrën e operacioneve që Shoqëria ka.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën aktuale:

- **Ndryshime në SNRF 1 "Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë"**- Hiperinflacioni i rëndë dhe heqja e datave fikse për adoptuesit për herë të parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- **Ndryshime në SNRF 7 "Instrumentat financiare:** Dhënia e informacioneve shpjeguese"- Transferimi i aktiveve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat"** – Tatimi i shtyrë: Mbulimi i aktiveve kryesore (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2012),

Adoptimi i këtyre ndryshimeve të standardeve dhe interpretimeve ekzistuese nuk ka sjellë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë.

3.2 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 9 "Instrumentat financiare"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2015),
- **SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 13 "Matja e vlerës së drejtë"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 27 (rishikuar në 2011) "Pasqyrat financiare individuale"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

- **SNK 28 (rishikuar në 2011) "Investime në filial dhe shoqëri të përbashkëta"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 1 "Adoptimi i SNRF-ve për herë të parë"** – Huatë qeveritare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 7 "Instrumentat financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese"** - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 9 "Instrumentat financiare" dhe SNRF 7** "Instrumentat financiare - Dhënia e informacioneve shpjeguese" – Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi dhe paraqitjet e kalimet.
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" dhe SNRF 12** "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" – Udhëzim për kalimin (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** – Shoqëritë investuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** – Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2012),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNK 32 "Instrumentat financiare: paraqitja"** – Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në disa standarde "Përmiresime në SNRF (2012)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve të publikuara më 17 maj 2012 (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **KIRFN 20 "Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqeje miniere"** – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Drejtimi parashikon se adoptimi i këtyre standardeve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të zbatimit.

3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.
Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.
Kurset zyrtare të këmbimit të Banka e Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
LEK / USD	101.86	105.85
LEK / EUR	140.20	139.59

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktivet afatgjata jomateriale

Marrëveshje për shërbime koncesionare
Shoqëria njeh aktiv jomaterial afatgjatë nga një marrëveshje shërbimi koncensionare në momentin kur i lind e drejta për përdorimin e infrastrukturës së koncensionit. Aktivet jomateriale afatgjata janë matur fillimisht me kosto e cila është vlera e drejtë e paguar për të marrë shërbimet koncensionare të marrëveshjes koncensionare. Pas njohjes fillestare aktivet jomateriale afatgjata maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga dëmtimet.

Shoqëria ka aplikuar KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Koncensionare* të efektshme për periudhën vjetore më apo pas dates 1 janar 2008. Interpretimi është aplikuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me IAS 8 Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet dhe gabimet kontabël të përshkruara në shënimin 22 të pasqyrave financiare. Sipas KNIRF 12 *Marrëveshjet për Shërbimet Koncensionare* aktivet afatgjata jomateriale përfaqësojnë të drejtën e Shoqërisë për të përfituar shërbimet koncensionare në këmbim të shpërblimeve jo monetare të kaluara dhënësit të grantit.

Sipas marrëveshjes ndërmjet Shoqërisë dhe dhuratëdhënësit aktivet afagjata jomaterile përfshijnë elementët që perfshijnë shpërblime jomonetare në këmbim të shërbimeve koncensionare të marra:

- *- Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)*

E drejta për të ofruar shërbime koncesionare në këmbim të përdorimit të Qendrave të Kontrollit Teknik ("QKT"), njihet në koston e investimit për projektim, financim, rehabilitim, testim, mirëmbajtje dhe përdorim të QKT-ve ekzistuese dhe pajisjeve të lidhura me të për të cilat konsiderohet si vlera e drejtë e tij.

- *- Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)*

Vlera e riinvestimit në 3 vjet aktivitet, paraqet një përmirësim të detyrueshëm të infrastrukturës së shërbimit të koncesionit zëvendësim në infrastrukturën origjinale të programeve dhe pajisjeve kompjuterike) i cili rrit jetën e aktivit. Shpenzimet e përmirësimit (të skontuara me vlerën aktuale me një normë para takes që paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet për detyrimin specifik) matet si një aktiv afatgjatë jomaterial dhe njihet në fillim të periudhës së koncesionit dhe amortizohet gjatë të gjithë periudhës së koncesionit.

- *Shpenzimet vijuese*

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përkasin. Shpenzimi tjetër është i njohur në pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje) kur ka ndodhur.

- *Amortizimi*

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivit afatgjatë jomaterial që i përket marrëveshjes së shërbimit koncesionar është periudha që kur vendoset në dispozicion deri në fund të periudhës së koncesionit, 3 shtator 2019.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivit e kalon vlerën e rikuperueshme te tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.
Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë së tij, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera.
Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivit.
Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga rivlerësimi nuk ekziston më dhe që ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi, rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

3.6 Aktive Financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivativ që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe detyrime tregatare dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativ njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto qe lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativ maten si më poshtë.
Në aktiv financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivit. Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivti. Detyrimet fianciare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë skadojnë, janë hequr ose anulluar.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i rreziqeve të rëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.
Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Aktive Financiare (vazhdim)

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesa konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.
Provigjoni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivet me maturitet afatshkurtër nuk diskontohen. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në bilanc mbyllet kundrejt provigjon për këtë llogari. Nëse shumat rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitmi ose humbje.

Huatë

Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar me cdo diferencë midis kostos dhe vlerës së rimarrjes dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa dhe kanë pasur një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar.
Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim bazë individuale. Aktivet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karekteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga rënia në vlerë anullohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga kryerja e shërbimeve. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t`u marrë nga Shoqëria për shërbimet e kryera, duke përjashtuar taksat e shitjes dhe zbritjet.

Shoqëria zbaton kriteret e njohjes së të ardhurave të paraqitura si më poshtë për secilën pjesë të identifikueshme të transaksionit të shitjes, në mënyrë që reflektojë përmbajtjen e transaksionit. Shpërblimi i marrë nga këto transaksione, është shpërndarë veçmas për secilin komponent duke marrë parasysh vlerën relative të drejtë për secilin komponent.

Kryerja e shërbimeve
E ardhura nga kryerja e shërbimeve njihet kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme. Kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe kur kriteret për secilën nga aktivitet e Shoqërisë janë plotësuar.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Këto kritere specifike të njohjes së të ardhurave nga aktiviteti janë bazuar në shërbimin e ofruar konsumatorit dhe kushteve të kontratës në secilin rast. Bazuar në Kontatën e koçesionit midis SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike, Shoqëria është e autorizuar të ofrojë shërbime inspektimi të mjeteve të transportit siç është përcaktuar në kontratën e koçesionit.

Të ardhura nga interesat
Të ardhurat nga interesat përllogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

3.8 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga kontributet në para të themeluesve të Shoqërisë. Kapitali aksionar mbahet në monedhën vendase LEK, i konvertuar nga monedha e huaj, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale

3.9 Përfitimet e detyrueshme të punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore
Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pensioneve sipas legjislacionit vendor. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

3.10 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin 2013 është 10% e të ardhurës së tatueshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Në bazë të pasigurive të lidhura me realizimin e aktivit tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e pëkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së koçesionit, Shoqëria nuk ka njohur një aktiv tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2012.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.11 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Provigjionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka mundësi për nevojën e një rrjedhë burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen.

3.12 Angazhime dhe detyrime të ardhshme

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një pasiv të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat fianciare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim lind në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

3.13 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Shoqërisë, së bashku me entitet që kontrollojnë, që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi veprimet dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të cdo marëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmëndja i drejtohet thelbit të marëdhënies, jo vetem formës ligjore.

3.14 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjartjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin fiananciar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë materiale.

3.15 Krahasues

Për qëllimin e krahasueshmërisë, interesi i përllogaritur I huave me vlerë 9,601,421 LEK (2012: 11,066,157) është riklasifikuar nga "Të pagueshme dhe të tjera" në "Hua".

4. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivet afatgjata jomateriale më 31dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	Pajisje IT	Të tjera	Riinvestimi	Totali
Kosto				
Gjendja më 31 dhjetor 2012	284,889,826	443,062,744	130,668,400	858,620,970
Shtesa	15,854,587	10,034,699	29,704,400	**55,593,687**
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**300,744,413**	**453,097,443**	**160,372,800**	**914,214,656**
Amortizime				
Gjendja më 31 dhjetor 2012	90,422,890	128,427,258	13,751,182	232,601,332
Shpenzimi për vitin	30,605,576	47,994,346	4,950,733	**83,550,655**
Pakësime	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**121,028,466**	**176,421,604**	**18,701,915**	**316,151,987**
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2012	**194,466,936**	**314,635,486**	**116,917,218**	**626,019,639**
31 dhjetor 2013	**179,715,947**	**276,675,839**	**141,670,885**	**598,062,671**

5. INVENTARI

Inventari më 31 Dhjetor 2013 and 31 Dhjetor 2012 mund të përmblidhet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme	477,715	2,312,890
Çertifikatë inspektimi dhe të tjera	1,474,967	2,911,158
	1,952,682	**5,224,048**

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme nga shitjet dhe të tjera më 31 Dhjetor 2013 and 31 Dhjetor 2012 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
Llogaritë e arkëtueshme		
Debitor vendas	74,490	68,680
Totali i llogarive të arkëtueshme	**74,490**	**68,680**
Të tjera llogari të arkëtueshme		
TVSH e arkëtueshme	37,036	36,928
Garanci te dhena	150,984	-
Parapagimet	13,719,538	14,809,178
Shpenzime te periudhave te ardhshme	3,753,810	
Tatim fitimi i parapaguar	-	4,496,652
Tatim ne burim	31,465	-
Të arkëtueshme nga personeli	229,656	95,721
Totali i llogarive të arkëtueshme të tjera	**17,922,489**	**19,438,479**
Llogaritë e arkëtueshme	**17,996,979**	**19,438,479**

Llogaritë e arkëtueshme nga shitjet dhe të tjera përbëhën nga debitorët vendas, parapagimet e bëra për ndërtimet në vendet e inspektimit dhe garanci te dhena per qera makinash ne vitin 2013.

7. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2013 and 2012 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
Llogaritë në banka në Lek	100,086,003	128,319,101
Deposite Bankare	190,463,919	-
Llogaritë në banka në monedhë të huaj	772,512	959,984
Llogaritë në arka në Lek	2,181,886	4,005,993
Llogaritë në arka në monedhë të huaj	14,891	685

Totali	293,519,210	133,285,763

8. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 dhjetor 2013 kapitali aksionar ka qënë LEK 190,000,100 (2012: LEK 190,000,100) dhe përfshin 1,900,001 aksione (2012: 1,900,001 aksione) me vlerë nominale Lek 100 për aksion, të zotëruara tërësisht nga SGS SOCIÉTÉ GÉNÉRALE DE SURVEILLANCE S.A.

9. HUATË AFATSHURTRA

Huatë më 31 dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 mund të përmblidhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
SGS SA, Geneva	426,448,012	426,448,012
Interes i përllogaritur	9,601,421	11,066,157
	436,049,433	**437,514,169**

Të gjitha huatë janë të marra nga Shoqëria mëmë dhe janë të pasiguruara. Huatë janë në LEK dhe mbartin interes. Interesi i huave për vitin 2013 lëviz ndërmjet 5.55% dhe 9.21%. Huatë maturohen më 7 Nëntor dhe 24 Korrik 2014.
Megjithatë, meqenëse marrëveshja i jep të drejtën Shoqërisë që në mënyrë të njëanshme të ndërpresë marrëveshjen, në tërësi ose pjesërisht me jo më pak se 30 ditë njoftim paraprak ndaj huadhënësit, huatë janë klasifikuar si afatshkurtra.

10. LLOGARITË E PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2013	Më 31 Dhjetor 2012
Llogaritë e pagueshme		
- Furitorë të huaj	744,119	8,127,656
- Furnitorë vendas	6,586,297	6,382,797
Totali i llogarive të pagueshme	**7,330,416**	**14,510,453**
Të tjera të pagueshme		
Të tjera të pagueshme	12,775,310	11,066,217
TVSH të pagueshme	19,791,745	11,096,091
Te pagueshme ndaj Punonjesve	12,399,869	10,571,485
Shpenzime të përllogaritura	9,211,600	7,227,015
Totali i të tjera të pagueshme	**54,178,525**	**39,960,808**
Totali	**61,508,941**	**54,471,261**

Të tjera të pagueshme janë të përbëra nga të pagueshme ndaj punonjësve, të pagueshme ndaj shtetit për sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, tatim fitimi per tu paguar dhe të pagueshme të tjera.

11. VLERA E RIINVESTIMIT

Detyrimi aktual për të riinvestuar 30.7% të investimit total është njohur si një detyrim afatgjatë, meqenëse daljet e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike, do të nevojiten për të mbyllur detyrimin në tre vitet e fundit të periudhës së marrëveshjes.
Shoqëria ka vlerësuar vlerën aktuale të riinvestimit më 31 Dhjetor 2013 në LEK 160,372,800

12. TË ARDHURA

Të ardhurat më 31 Dhjetor 2013 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012**
Tarifa për inspektimin e automjeteve	634,514,031	539,886,302
TOTALI	**634,514,031**	**539,886,302**

Shuma e deklaruar ne FDP per Qarkullimin Total eshte **694,829,279 Lek** sipas zerave te meposhtem:

Shitje e sherbimit te kontrollit teknik te automjeteve	635,338,671
Autofaturime	59,490,608

Nga shitja e sherbimit, shoqeria ka njohur si te ardhura te shtyra vleren ***824,640 lek*** e cila eshte vlere e lidhur me sherbimet e faturuara dhe te likuiduara por qe nuk u jane ofruar klienteve brenda vitit ushtrimor. Kete vlere e gjeni te kalsifikuar ne zerin ***"Parapagime te marra"*** ne pasivet e shoqerise per vitin ushtrimor.

13. MATERIALE TË PËRDORURA

Materialet e përdorura më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012**
Elektriciteti, uji dhe karburanti	6,466,790	6,858,469
Materiale ndihmëse dhe të konsumueshme nga shërbimet	5,836,698	4,424,035
Të tjera	2,086,272	409,330
TOTALI	**14,389,760**	**11,691,834**

14. SHPENZIME PERSONELI

Kostot e personelit më 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Pagat bruto	135,472,921	128,104,687
Sigurimet shoqërore	18,137,861	17,722,763
Përllogaritje për bonuset	7,506,314	6,115,298
Përllogaritje për pushimet	(688,226)	(743,527)
Të tjera	3,235,306	7,279,981
TOTALI	**163,664,176**	**158,479,202**

15. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative janë te detajuara si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shpenzime logjistike dhe të ngjashme	77,639,980	68,407,597
Mirëmbajtja	37,394,542	40,807,938
Tarifa e konçesionit	84,395,495	76,342,035
Qira	9,922,665	9,160,576
Taksa dhe tarifa	3,191,472	3,182,892
Shpenzime transporti	4,015,130	3,410,665
Pajisje për zyra	1,702,438	1,557,773
Sigurime	3,484,768	3,362,299
Shpenzime të tjera	1,187,896	1,228,928
Shpenzime telekomunikacioni	2,280,636	1,563,923
Penalitete	5,728,923	2,511,734
Shërbime noteriale	1,011,348	669,627
Shpenzime dietash dhe udhëtime	2,116,574	1,990,465
Komisione bankare	352,624	507,217
Shpenzime marketingu dhe promovimi	437,056	494,598
TOTALI	**234,861,546**	**215,198,267**

16. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Kostot dhe të ardhurat financiare detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Të ardhurat nga financimi		
Të ardhurat nga kursi i këmbimit	36,080	1,773,612
Totali i të ardhurave nga financimi	**36,080**	**1,773,612**

Financimi (kostot)		
Shpenzime interesi	(36,556,300)	(42,117,509)
Humbje nga kursi i këmbimit	(242,127)	(1,221,626)
Kosto të tjera financimi	461,366	(13,348)
Totali i humbjeve nga financimi	**(36,337,061)**	**(43,352,483)**
Kostot financiare, neto	**(36,300,980)**	**(41,578,871)**

17. TATIMI MBI FITIMIN

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	%	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012	%
Fitimi para tatimit	**101,733,414**	**100%**	**38,766,131**	**100%**
Norma e tatim fitimit	10,173,341	10%	3,876,613	10%
Shpenzimet e pazbritshme	4,627,101	5%	2,616,059	7%
Shpenzime tatim fitimi (10%)	**14,800,442**	**15%**	**6,492,672**	**17%**

Lista e detajuar e shpenzimeve te pazbritshme fiskalisht:

Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal 2013	
a- Gjoba	5,728,923
b-shpenzime per personelin	4,553,352
c- shpenzime pa fatura te rregullta	2,842,438
d-Amortizime	32,618,314
e-borxhi I keq	13,500
f -dhurata	514,482
Totali I shpenzimeve te pazbritshme	**46,271,009**

Kompania është subjekt i taksës mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e tatimit është 10% për 2013. Formularët e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Ligjet shqiptare dhe rregullat e taksimit janë subjekt i interpretimit nga autoritetet e taksave.

18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Angazhimet
Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

Detyrimet e taksave
Për vitet 2009 - 2011, regjistrimet dhe librat tatimor të Shoqërisë janë inspektuar nga autoritetet tatimore vendase. Shoqëria ka ndjekur të gjitha rregullat dhe rregulloret tatimore në llogaritjen e detyrimeve tatimore, gjithsesi interpretimet e taksave sipas autoriteteve tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga Shoqëria.

Çështje Gjyqësore

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria është e përfshirë në disa raste gjyqësore të cilat janë në Gjykatën e Apelit të Tiranës dhe në Gjykatën Administrative. Rastet gjyqësore të cilat nuk janë zgjidhur deri më 31 Dhjetor 2013 janë:

1. Rasti i parë ka kërkuar nga gjykata dorëzimin nga Shoqëria të një pjese të pronës, në të cilën ndodhet aktualisht Qëndra e Inspektimit të Automjeteve e Tiranës, dëtyrimin e marrjes me qira nga Shoqëria si dhe pagesën kundrejt paditësit të të ardhurave që janë marrë që nga përdorimi i pronës deri më datën e përmbushjes së detyrimit. Gjykata e Tiranës ka vendosur në 2011 të deklarojë debitore Shoqërinë dhe Ministrinë për pagesën e qirasë së pronës, QKT –Tirana që nga 3 shtator 2009 deri në lirimin e objektit. Gjykata e Apelit e Tiranës ka vendosur në qershor 2012 të kthejë çështjen në gjyq. Rasti është rregjistruar në Gjykatën Administrative por seanca dëgjimore nuk ka filluar.
2. Rasti i dyte është një padi kundrejt Drejtorisë Rajonale të Durrësit lidhur me disa gjoba të vendosura për mosmarrjen e lejes mjedisore. Gjykata e Rrethit të Tiranës ka vendosur në favor të SGS Automotive por Drejtoria Rajonale e Durrësit ka apeluar çështjen në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Kjo Gjykate e ka kthyer ceshtjen per gjykim ne Gjykaten Administrative.

Nuk ka çështje të tjera gjyqësore ku Shoqëria ka ngritur kërkesa ose raste ku Shoqëria është e akuzuar, për këtë arsye Drejtimi beson që rezultati i ardhshëm i padive të mësipërme nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në përformancën financiare dhe aktivitetet e Shoqërisë.

18. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat mund të kërkojnë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

SGS

Efekti I vlerave te AUTOFATURAVE ne FDP
Viti 2013

SHITJE SIPAS FDP	Janar 2013	Shkurt 2013	Mars 2013	Prill 2013	Maj 2013	Qershor 2013	Korrik 2013	Gusht 2013	Shtator 2013	Tetor 2013	Nentor 2013	Dhjetor 2013	TOTAL 2013
Qarkullimi I tatueshem	49,143,255	36,913,538	93,755,708	30,104,382	45,978,500	56,318,413	54,517,617	47,840,742	51,467,524	58,320,111	57,158,385	113,311,104	694,829,279
Eksporte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shitje te Perjashtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali I Qarkullimit	**49,143,255**	**36,913,538**	**93,755,708**	**30,104,382**	**45,978,500**	**56,318,413**	**54,517,617**	**47,840,742**	**51,467,524**	**58,320,111**	**57,158,385**	**113,311,104**	**694,829,279**
Blerjet SIPAS FDP													
Blerje te Tatueshme	11,201,918	12,197,697	74,554,212	14,835,657	13,136,966	12,486,611	10,194,330	12,250,099	10,383,771	10,194,024	11,299,494	11,759,189	204,493,968
Importe	0	0	0	0	4,315,875	0				0	0	0	4,315,875
Blereje te Taueshme 10%				21,273									21,273
Blerje te Perjashtuara	1,764,655	1,475,010	1,439,754	2,163,898	2,430,878	3,091,754	1,421,056	1,360,534	1,552,511	3,497,755	1,774,008	2,341,666	24,313,480
Totali Blerje	**12,966,573**	**13,672,707**	**75,993,966**	**17,020,828**	**19,883,719**	**15,578,365**	**11,615,385**	**13,610,633**	**11,936,281**	**13,691,779**	**13,073,503**	**14,100,855**	233,144,596
SHITJE REALE													
Qarkullimi I tatueshem	49,066,508	36,410,692	38,413,675	29,996,550	45,978,500	56,108,958	54,517,617	47,840,742	50,725,715	56,374,316	56,632,374	113,273,024	635,338,671
Eksporte	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shitje te Perjashtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali I Qarkullimit	**49,066,508**	**36,410,692**	**38,413,675**	**29,996,550**	**45,978,500**	**56,108,958**	**54,517,617**	**47,840,742**	**50,725,715**	**56,374,316**	**56,632,374**	**113,273,024**	635,338,671
Blerjet REALE													
Blerje te Tatueshme	11,125,171	11,694,851	19,212,179	14,727,825	13,136,966	12,277,156	10,194,330	12,250,099	9,641,961	8,248,229	10,773,484	11,721,109	145,003,360
Importe	0	0	0	0	4,315,875	0	0	0	0	0	0	0	4,315,875
Blereje te Taueshme 10%				21,273									21,273
Blerje te Perjashtuara	1,764,655	1,475,010	1,439,754	2,163,898	2,430,878	3,091,754	1,421,056	1,360,534	1,552,511	3,497,755	1,774,008	2,341,666	24,313,480
Totali Blerje	**12,889,826**	**13,169,861**	**20,651,933**	**16,912,996**	**19,883,719**	**15,368,910**	**11,615,385**	**13,610,633**	**11,194,472**	**11,745,984**	**12,547,492**	**14,062,775**	173,653,988
													-
Diferenca ne Shitje	76,747	502,846	55,342,033	107,832	0	209,455	0	0	741,809	1,945,795	526,011	38,080	59,490,608
Diferenca ne Blerje te Tatueshme	76,747	502,846	55,342,033	107,832	0	209,455	0	0	741,809	1,945,795	526,011	38,080	59,490,608
Diferenca ne Blerje te Perjashtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total Diferenca AUTOFATURAT	153,494	1,005,693	110,684,066	215,664	0	418,909	0	0	1,483,618	3,891,590	1,052,021	76,160	118,981,216

Diferenca ne shitjet totale te deklaruar ne FDP gjate vitit 2013 me shitjet reale te ndodhura shkon ne shumen e 59,490,608 ALL.
Kjo diference eshte e lidhur dhe me furnizimet ne blerje perben vleren e blerjeve nga furnitore te huaj.

Shuma shtese ne Shitje eshte e barabarte me shumen shtese ne blerjet e tatueshme e barabarte me shumen minus ne blerjet e perjashtuara
Ky efet krijohet nga mekanizimi I autofaturimit sipas kerkeses se Ligjit per TVSH per vertetimin dhe dokumentim e furnizimeve te huaja.

Shitjet reale ne vleren 635,338,671 Leke jane klasifikuar nga shoqeria si Shitje te Tatueshme ne vleren 634,514,031 Leke dhe te ardhura te shtyra ne vleren 824,640 Leke.

SGS Automotive Albania
Rr. Irfan Tomini Pall G&P kati I Tirane, Kutia Postare 2408
Tel +355 4 2357965 Fax +355 44 500482 VAT No. K92110020V. www.sgs.com

Member of SGS Group (Société Générale de Surveillance)